

---


# Analizë e Raportit Vjetor të ZRRE-së për vitin 2019

---

Analizë Politikash

---

03/2020



# Analizë e Raportit Vjetor të ZRRE-së për vitin 2019

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Maj 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje.....	2
Mbi Vendimin për Tarifat Nxitëse për 20MW Solare .....	3
Analiza e Raportit.....	3
Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji .....	3
Aktivitetet e prokurimit.....	4
Aktivitetet e Zyrës së Rregullatorit për Energji .....	4
Bashkëpunimi me palët tjera dhe transparenca .....	8
Raportimi financiar për Rregullatorin .....	8
Reduktimet.....	9
Përfundime dhe Rekomandime.....	10
Shtojcë - Pyetjet pa përgjigje në Raportin Vjetor të ZRRE-së për vitin 2019 .....	10

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit Kuvendi i Fuqizuar për Politika dhe Ligjvënje Efektive, të Përgjegjshme dhe Gjithpërfshirëse dhe si pjesë e programit për Qeverisje Demokratike, ka analizuar Raportin Vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për vitin 2019. Analiza e INDEP është e fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e kualitetit të raportimit, të gjendjes së sektorit të energjisë në Kosovë si dhe në hartimin e rekomandimeve për Komisionin parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është agjenci e pavarur e cila është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e kornizës rregullative për sektorin e energjisë në Kosovë. Detyrat dhe funksionet e ZRRE janë të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084. Ato përfshijnë: krijimin dhe funksionimin e tregut të energjisë, përcaktimin e kriterëve dhe dhënien e licencave dhe kapaciteteve të reja për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë, monitorimin e tregut, përmirësimin e sigurisë së furnizimit me energji, vendosjen e tarifave të arsyeshme për aktivitetet e energjisë, monitorimin dhe parandalimin e krijimit të pozitës dominuese dhe praktikave jo-konkurruese nga ndërmarrjet e energjisë, si dhe zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë.

Zyra e Rregullatorit për Energji raporton në Kuvend në baza vjetore. Përmes raportit Kuvendi ka mundësi që të informohet rreth gjendjes aktuale, sfidave dhe projekteve mbi fushën e energjisë në vend. Prandaj, ky raport ka rëndësi të madhe për Kuvendin dhe organizatat të cilat bëjnë monitorimin e punës në Kuvend. Raporti poashtu ka për qëllim edhe informimin e qytetarëve, investitorëve potencial, shoqërisë etj. Prandaj gjuha e përdorur dhe kualiteti i raportimit në këto raporte kanë rëndësi të madhe në realizimin e llogaridhënies dhe transparencës sa i përket fushës së energjisë por edhe nxitjes së investimeve dhe edukimit të përgjithshëm në anën tjetër.

Analiza e INDEP është organizuar në atë mënyrë që të pasqyrojë strukturën e raportit të ZRRE dhe ndjek një logjikë që të shkohet drejtëpërdrejtë në gjetje dhe pyetje të cilat mund t'i kontribuojnë diskutimit në Komision. Kjo analizë është hartuar në kuadër të projektit që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED). Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED.

## Mbi Vendimin për Tarifat Nxitëse për 20MW Solare

Kur me 2 maj 2019, ZRRE kishte vënë në diskutim publik Raportin Konsultativ për “Mekanizmin e Mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike)”, Instituti për Politika Zhvillimore kishte qenë ndër të parët dhe të vetmit që kishte dërguar komente me shkrim. Në analizën tonë, ne analizuam draftin e dokumentit në dy rrafshë:

1. Ligjshmërinë e dokumentit të propozuar
2. Lartësinë e propozuar të tarifës nxitëse

Ne argumentuam para ZRRE-së se dokumenti i propozuar binte ndesh me Ligjin 05/L-081 për Energjinë dhe rrjedhimisht nuk duhej zbatuar.

Udhëzimi Administrativ i vitit 2017, me ndryshimin e caqeve të cilat kanë pasur kosto për qytetarët, ka shkelur ligjin pasi nuk mundet që një akt nënligjor ta mbizotëroj ligjin. Për këtë, Zyra e Rregullatorit për Energji nuk do të duhej fare ta merrte parasysh dhe ta zbatonte një udhëzim administrativ antiligjor. Ky vendim i Ministrisë gjithashtu ishte arbitrare dhe i pa konsultuar. Shkelte nenin 6, pikën 9 të Ligjit Nr. 05/L-081 që parashihte se: “të gjitha dokumentet dhe udhëzimet që përgatiten nga Ministria do t’i nënshtrohen kërkesave të njëjta për konsultime publike dhe miratohen nga Ministria” Nuk kishte pasur fare konsultim publik, nuk ishte informuar e as konsultuar ZRRE dhe si rrjedhojë, një vendim me kosto për qytetarët, ishte marrë pa u konsultuar me ta. Pra, ky udhëzim është i paligjshëm, i marrë në mënyrë të paligjshme dhe të gjitha pasojat juridike pas tij janë të paligjshme.


Gjithashtu, ne komentuam edhe materien e dokumentit më saktësisht lartësinë e tarifës së propozuar. Ajo ishte propozuar në vlerën 90.5 EUR që ishte jashtëzakonisht e lartë. Ne gjithashtu argumentuam që ky nivel i tarifës ishte i papranueshëm dhe binte ndesh me gjendjen reale të tregut dhe me faktin që kostoja e investimit në panele solare vetëm nga viti 2010 kishte rënë për 80%. Në fund, ZRRE nuk e tërhoqi këtë draft dhe ndënëse e uli nga 90.5 EUR në 85.5 EUR lartësinë e tarifës nxitëse, prapë se prapë ky është një nivel i lartë dhe në shpërputhje me realitetin e një tregu që gjithnjë po ulë kostot e po rritë konkurrencën.

Edhe pse me këtë ulje nga niveli i propozuar prej 90.5 EUR në nivelin 85.5 EUR ne jemi të kënaqur që janë kursyer mbi 2 milion euro të qytetarëve, nuk mund të themi nëse ky ndryshim sado pak pozitiv ishte si rezultat i komenteve që kemi dërguar. ZRRE asnjëherë nuk ju kthen me shkrim komente palëve në lidhje me komentet që ata bëjnë. Ne konsiderojmë që duhet të ndyshoj qasja që ZRRE ka ndaj palëve që parashtrojnë komente dhe se në fund të çdo procesi të konsultimit duhet të publikohet një raport i detajuar i konsultimit publik. Përfundimisht, është koha e fundit që të kalohet në një sistem kompetitiv të skemave mbështetëse për BRE-të. Ky 20 megavatësh ishte një rast shumë i mirë po që se MZHE dhe ZRRE të mbronin interesin publik dhe ligjshmërinë.

## Analiza e Raportit

### Përshkrimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Në pjesën ku bëhet përshkrimi i strukturës së bordit të ZRRE, raporti ka dhënë informata të përgjithshme rreth përbërjes dhe mandatit ligjor të anëtarëve. Në këtë pjesë është përshkruar bordi



dhe janë dhënë emrat e anëtarëve të bordit, mirëpo edhe në këtë raport mungon pjesa ku përshkruhet koha e skadimit të mandatit të tyre. Duke u bazuar në problemet e viteve paraprake të cilat janë paraqitur për këtë shkak, ne konsiderojmë se informimi i deputetëve mbi kohën kur i skadon mandati secilit anëtar të bordit është shumë i rëndësishëm.

Raporti duhet të paraqes edhe pasqyrën e informatave mbi burimet njerëzore të Rregullatorit. Në pjesën ku përshkruhet struktura organizative e Rregullatorit, nuk ka informata të hollësishme rreth strukturës gjinore, moshës, përgatitjes profesionale dhe trajnimeve të ndjekura.

Raporti e paraqet në tabelën 2.1 strukturën organizative të Rregullatorit. Në këtë tabelë janë të përshkruara numri i vendeve të planifikuara, të punësuara dhe vendet e lira. Sipas këtyre të dhënave, në bordin e ZRRE mungon një anëtar i bordit, pozitë kjo e cila gjatë gjithë vitit ka mbetur e lirë, si dhe në departamentin për mbrojtjen e konsumatorëve ndodhet një pozitë e lirë. Pavarësisht këtyre dy mungesave, raporti nuk spjegon se a ka ndikuar në performancën e tij dhe a ka pasur konkurse rreth këtyre pozitave?

Në raport poashtu thuhet se: Personeli i Rregullatorit është një ekip ekspertësh me performancë të dëshmuar në fushat e përgjegjësive që ata mbulojnë. Ky kombinim eksperiencash inxhinierike, ekonomike, juridike dhe të tjera e përforcon besimin për një institucion me strategji të qartë drejt suksesit në zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë. Mirëpo, në këtë pjesë mungojnë sqarimet në lidhje me nevojën ose jo për pozita të reja dhe për përgatitje profesionale.

Në raport theksohet se: Bordi i ZRRE-së ka përkrahur ngritjen profesionale të stafit të ZRRE-së duke synuar specializimin e punonjësve në profilet përkatëse në kuadër të përgjegjësive të tyre, përmes trajnimeve të ndryshme të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Në përjashtim të kësaj fjalie, nuk jepet asnjë informatë lidhur me trajnimet që janë mbajtur dhe çfarë ato trajnime kanë ndihmuar në përmirësimin e punës së ZRRE. Këto informata mungojnë komplet në këtë raport, sikurse edhe në raportet e kaluara.

### **Aktivitetet e prokurimit**

Në raport, në pjesën e aktiviteteve të prokurimit, thuhet:

Rregullatori është duke u përballur me shumë probleme si pasojë e mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). Si pasojë e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik, operimi i zyrës është vështirësuar nga procedurat e stërzgjatura të ndjekura nga AQP, gjatë zhvillimit të aktiviteteve të prokurimit. Kjo ka bërë që zyra akoma të mbetet pa shërbime dhe furnizime të cilat janë të domosdoshme për një funksionim normal të saj.

Pra, për dallim nga raporti i vitit të kaluar, Rregullatori në raportin e këtij viti thekson se vonesat në procedura të prokurimit kanë ndikuar në kryerjen e misionit të ZRRE-së. Megjithatë, nuk përmenden aspak se cilat kanë qenë mënyrat se si ka ndikuar kjo vonesë nga ana e AQP-së. A është përkthyer në më pak vendime të marra, në zvarritjen e ndonjë investimi kapital, në ulje të performancës së punonjësve apo ku ndodhet impakti i këtyre vonesave? Gjithashtu, ZRRE duhet të japë një pasqyrë se si e sheh adresimin e këtij problem që gjithnjë e më shumë po shfaqet në raporte të agjencive të paravarura.

### **Aktivitetet e Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Në pjesën ku përshkruhen aktivitetet e Rregullatorit, mungojnë disa informata rreth një pasqyre të thjeshtësuar të legjislacionit. Siç edhe përshkruhet në raport: Sipas Nenit 29 të Ligjit për rregullatorin e energjisë, prodhimi i energjisë për gjeneratorët që janë me kapacitet më të madh se 5 MW nuk mund të bëhet pa pasur licencë të lëshuar nga Rregullatori. Licencimi veçmas në fushën e burimeve të ripërtrishme, nuk është një proces i thjeshtë. Prandaj një mënyrë e thjeshtësuar, e paraqitur në formë grafikoni do të duhet të shpjegonte se nëpër çfarë procedurash duhen kaluar investitorët për të licencuar investimet e planifikuara në fushën e energjisë së ripërtrishme.

Në raport shpjegohen të ashtuquajturat “licenca të përkohshme”. Për shembull, me rastin e ndërmarrjes Kelkos:

Kjo ndërmarrje ka aplikuar në rregullator për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, për tri (3) njësi prodhuese. Në mungesë të dokumentacionit të kompletuar, nuk është marrë vendim për licencim të kësaj ndërmarrjeje deri në vitin 2019. Kështu Bordi i Rregullatorit gjatë këtij viti, më konkretisht me datë 14 tetor 2019, me vendimin V\_1182\_2019, V\_1183\_2019, dhe V\_1184\_2019, ndërmarrjes në fjalë i ka lëshuar licencë të përkohshme për të tri hidrocentralet, duke obliguar ndërmarrjen që brenda afatit të përcaktuar në vendim të sjell në Rregullator Lejen Mjedisore të Integruar brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të vendimit.

Mirëpo raporti nuk sqaron se mbi çfarë baze është marrë një vendim i tillë kur dihet që në Ligj nuk ekziston termi “licencë e përkohshme”. Si do ndërpritet operimi i këtyre ndërmarrjeve dhe si do arsyetohet degradimi dhe ndotja e ambientit që ka ndodhur si rezultat i ndërtimeve dhe operimeve të këtyre ndërmarrjeve. Prandaj lidhur me këto çështje, shtrohen pytjet se:

### **Në bazë të cilit ligj lëshohen këto licenca të përkohshme?**

Në pjesën ku përshkruhet licencimi i aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, theksohet se për dallim prej viteve paraprake ku interesimi ka qenë shumë i lartë, këtë vit ka aplikuar vetëm një ndërmarrje (Enerco LLC. SH.P.K.e). Megjithatë, as kjo ndërmarrje e as shtatë ndërmarrjet e tjera të licencuara më parë, përveç KESCO nuk kanë hyrë në treg për të furnizuar konsumatorët me energji elektrike. Në procesin e liberalizimit të tregut, operimi i furnizuesve të energjisë elektrike është jashtëzakonisht i rëndësishëm, kjo pasi që plotëson të drejtën e konsumatorëve për ndërrim të furnitorëve, e përcaktuar me nenin 36 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike. Prandaj ky raport duhet të sqarojë se cilat janë arsyet për të cilat furnitorët nuk po ofrojnë shërbime në treg dhe se çfarë ka bërë Rregullatori gjatë vitit 2019 për të përmbushur këtë të drejtë të konsumatorëve?

Në vazhdim të analizimit të pjesës së licencimit të aktiviteteve për furnizim, përmendet se: Kohëzgjatja e licencës së furnizimit përcaktohet varësisht nga gjendja financiare e aplikantit me kohëzgjatje maksimale prej njëzet e pesë (25) vjetësh ndërsa sa i përket ndërmarrjes Enerco LLC. SH.P.K Bordi i Rregullatorit i ka lëshuar licencë për periudhë pesë (5) vjeçare në pajtim me nenin 32 të ligjit për rregullatorin e energjisë. Nuk ka asnjë spjegim në lidhje me fjalinë “varësisht nga gjendja financiare”, pra çfarë merr parasysh Rregullatori kur e përmend gjendjen financiare. Më konkretisht, raporti do të ishte mirë të sqaronte se çfarë pragjesh ekzistojnë për dhënjen e licencës dhe se çfarë gjendje financiare duhet të ketë ndërmarrja që të merr kohëzgjatje të caktuar të licencës.

Në pjesën për monitorimin e ndërmarrjeve të energjisë raporti ka mungesë të informatave substacionale në lidhje me monitorimin. Raporti vetëm sqaron se ka pasur monitorime dhe janë përmendur format e monitorimit përfshirë bazën ligjore për kryerjen e tyre. Por, mungojnë shifra reale se sa monitorime janë kryer, cila ka qenë metodologjia, cilat kanë qenë gjetjet dhe se a janë gjetje që përsëriten apo janë të reja. Duhet theksuar se monitorimi i akterëve në tregun e energjisë në Kosovë është një nga përgjegjësitë kryesore të Zyrës së Rregullatorit për Energji. Duke pasur parasysh se të dhënat për këtë proces janë jashtëzakonisht të rëndësishme për të parë se sa po e kryen mandatin e vet ZRRE, nevojitet një pamje më e qartë se cilat janë shifrat reale të monitorimit.

**Nga monitorimi i ZRRE-së është raportuar se nuk është shqiptuar asnjë gjobë për ndërmarrjet e energjisë, ndërkohë që nga ankesat e konsumatorëve 73% kanë dalë të jenë të drejta dhe janë vendosur në favor të konsumatorëve.**

Të njëjtin trend të sqarimeve, raporti e vazhdon edhe tek pjesa e monitorimit të investimeve kapitale ku audiencës i referohet të kërkojë për hollësitë e monitorimeve në linkun e bashkangjitur:

Hollësitë nga raporti i monitorimit të investimeve kapitale për KOSTT dhe KEDS për vitin 2018 mund të gjinden në raportin e publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së në linkun.

Pra, raporti dhe linku i ofruar nga ZRRE i përket vitit 2018 dhe jo vitit 2019. Në këtë pjesë, ZRRE duhet të ofroj shpjegime mbi raportin e monitorimit për vitin 2019 se përse nuk është cituar në raport vjetor dhe se cilat kanë qenë gjetjet kryesore dhe rekomandimet. Duke parë raportin e 2018, INDEP vëren se raporti është tejet i cekët, me rekomandime të përgjithshme dhe pa një analizë të duhur të gjetjeve.

Sikurse në rastet e mesipërme, edhe tek monitorimi i ndërtimit të kapaciteteve regjenerueses nuk jepet asnjë detaj lidhur me to. Raporti thekson se janë bërë monitorime dhe i tregon kapacitetet e prodhimeve për këto ndërtime, mirëpo nuk jep detaje në lidhje me fazat të cilat gjenden këto ndërtime, sidhe në problemet dhe sfidat në të cilat kanë hasur këto ndërtime. Raporti shkruan shkurt në mënyrë të përgjithshme për këtë pjesë, pa u ndalur në detaje.

Raporti në përgjithësi duhet të përmbajë të gjitha të dhënat mbi monitorimin sepse ky proces garanton mbrojtjen e interesit publik dhe ruajtjen e ligjshmërisë. Në formën e tanishme, Raporti i ZRRE-së nuk ofron asnjë të dhënë të detajizuar lidhur me këtë pjesë dhe asnjë analizë për monitorimin.

Në pjesën e autorizimeve preliminare dhe autorizimeve finale për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, edhe këtë vit sikurse vitet e tjera mungon një analizë objektive dhe substanciale mbi shkaqet, tregun dhe situatën ligjore dhe praktike. Në pjesën e raportimit mbi autorizimet preliminare sektori i energjisë për panele solare ka rritje të theksuar krahasuar me vitet e tjera. Kurse sa i përket sektorit të hidrocentraleve dhe erës, vërehet një rënie në këtë pjesë.






Figure 1. Autorizimet preliminare ndër vite. Burimi: ZRRE

Nga ana tjetër, ka një rënje të autorizimeve finale të lëshuara por që raporti nuk jep detaje të mjaftueshme lidhur me arsyet dhe se çfarë ka bërë e po bënë ZRRE për të liruar kapacitetet e zëna?




Figure 2. Autorizimet finale ndër vite. Burimi: ZRRE

Në pjesën ku sqarohen të dhënat rreth gjeneratorëve për vetë-konsum, raporti jep detaje lidhur me 20 vendimet e lëshuara nga Bordi i ZRRE-së, për gjeneratorët për vetë-konsum gjatë vitit 2019. Më tutje raporti thekson se: ZRRE, poashtu ka pranuar edhe kërkesa tjera nga personat fizik dhe juridik, të cilat janë në faza të ndryshme të kompletimit dhe sipas procedurave në fuqi, pas kompletimit do të lejohen në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga gjeneratorët për vetë-konsum.

Kjo ka shumë rëndësi pasi që konsumatorët me vetë-konsum ndikojnë në uljen e konsumit dhe për ushqimin e rrjetit me energji.

Në kuadër të nxitjes së prodhimit të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë, raporti thotë se këtë temë e kanë trajtuar me mjaft kujdes. Kjo sipas tyre është bërë duke krijuar mekanizma të përshtatshëm dhe të parashikueshëm për kohën dhe rrethanat ekonomiko-sociale të Kosovës. Sipas ZRRE, këta mekanizma kanë rezultuar mjaft efikas, duke mbuluar në masë të madhe caqet në teknologji të ndryshme me aplikacione për investime, dhe kohë pas kohe i ka përshtatur këtyre mekanizmave ndryshimet ligjore dhe kushtet e të bërit biznes në Kosovë dhe rajon.

Sa i përket Projektit “Kosova e Re”, Zyra e Rregullatorit për Energji në raportin e vitit 2019 është krejtësisht e heshtur. Në vitin 2018 ZRRE kishte vënë në diskutim publik vënjen e një Obligimi të Shërbimit Publik mbi furnizuesit që furnizojnë konsumatorët në Kosovë që të paguajnë një taksë për NKEC, për të siguruar kthim të sigurt të investimeve të bëra nga investitori sipas marrëveshjes së nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës dhe investitorit.” Megjithatë, në raportin e vitit 2019, ZRRE nuk e përmend Projektin dhe nuk jep kurrfarë sqarime në lidhje me projektin.

### **Bashkëpunimi me palët tjera dhe transparencja**

Zyra e Rregullatorit për Energji nuk është e shquar për transparencë dhe bashkëpunim ashtu siç thuhet në raport. INDEP gjatë vitit 2019 ka analizuar raporte konsultative dhe dokumente të ZRRE-së dhe ka dërguar komente. Në asnjërin nga këto analiza dhe komente, ne nuk kemi marrë përgjigje me shkrim mbi statusin e tyre, pranimin apo refuzimin e tyre. Në përgjithësi, Rregullatori nuk raporton se sa vendime gjatë vitit 2019 janë ndryshuar apo modifikuar si rezultat i konsultimeve publike? A ekzistojnë raporte të konsultimit me palët ku sqarohen të gjitha komentet dhe shqyrtohen me objektivitet?

Në raport paraqitet edhe pjesa që flitet për bashkëpunimin me palët e tjera dhe transparencën. Në këtë pjesë theksohet se gjatë vitit 2019 janë publikuar 20 komunikata për shtyp, 11 njoftime, 2 Buletinet dhe janë shpallur 7 diskutime publike. Në pika të shkurtëra përshkruan diskutimet publike të mbajtura. Në këto përshkrime mungojë të dhënat në lidhje me numrin e pjesëmarrësve në dëgjime, numrin e komenteve të marra apo rezultateve të arritura nga ato dëgjime, tryeza dhe konsulta. Pra, ZRRE në këtë pjesë nuk raporton se:

### **Raportimi financiar për Rregullatorin**

Buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Në bazë të ligjit nr.06/L-133 Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2019 ishte 836,789€. Rregullatori gjatë vitit 2019 ka realizuar të hyra në shumë prej 1,329,192.29€, kurse të hyrat e pashpenzuara, në pajtim me nenin 23 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, janë derdhur në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Buxheti i Rregullatorit për vitin 2019 është shkurtuar. Ky shkurtim është bërë me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës në kategorinë ekonomike “paga dhe mëditje”, 14,000.00€, në kategorinë ekonomike “mallra dhe shërbime”, 5,611.00€, në kategorinë ekonomike “shpenzime komunale” dhe 42,000.00€ në kategorinë ekonomike “shpenzime kapitale”. Shprehur në përqindje buxheti i ZRRE-së është shkurtuar për 12.98 %. Ky shkurtim ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të pozitave të punës, sidhe të mosrealizimit të procedurave të prokurimit nga ana e AQP. Mirëpo, nuk ka asnjë sqarim në lidhje me sfidave që i kanë hasur si rezultat i këtyre problemeve. Mosrealizimi i procedurave të prokurimit nga ana e AQP-së a ka ndikuar në performancën e ZRRE-së dhe se cilat kanë qenë vështirësitë.

**Edhe pse ZRRE mbledh taksa të dedikuara për shpenzimet e saja, ato nuk trajtohen si të hyra të dedikuara por derdhen në buxhetin e Kosovës dhe pastaj i ndahen ZRRE-së në formë granti. Pra, konsumatorët paguajnë më shumë se që realisht i kthehen ZRRE-së.**

Vlenë të theksohet se buxheti i shpenzuar për mëditje është më i lartë se buxheti për shpenzime të udhëtimit. Për këtë, duhet kërkuar një sqarim nga ana e ZRRE-së se si është e mundshme që shpenzimet e meditive të tejkalojnë shpenzimet e udhëtimit dhe se cilat janë politikat e ZRRE-së rreth shpenzimeve të udhëtimit. Për këtë pjesë në raport nuk egziton ndonjë sqarim më i detajizuar.

Sa i përket realizimeve të projekteve, në raport thuhet se ZRRE për vitin 2019 ka planifikuar buxhet prej 72,000.00€ për realizimin e dy projekteve. Prej këtyre dy projekteve, është realizuar vetëm njëri, ndërsa projekti i dytë në vlerë të parashikuar prej 42,000.00€ siç shkruhet në nuk është realizuar për shkak të moskryerjes së procedurave të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, përkundër faktit se iniciimi i procedurave nga ZRRE është bërë në fillim të vitit 2019. Sa i përket të dhënave rreth këtyre projektve, raporti nuk jep kurrfarë detaje.

Një e dhënë shqetësuese e paraqitur në raport është niveli i realizimit të investimeve kapitale. Vetëm 31,56% e investimeve kapitale janë realizuar gjatë vitit 2018. ZRRE sqaron se arsyeja kryesore për këtë janë procedurat në Agjencinë Qëndrore të Prokurimit. Megjithatë, nuk ka asnjë sqarim se çfarë investimesh kapitale s’kanë mundur të realizohen, cilat do të ishin ndikimet e këtij/këtyre investimeve që nuk janë realizuar dhe se sa ka ndikuar në realizimin e mandatit të ZRRE-së.

## **Reduktimet**

Sa i përket reduktimeve, Rregullatori thekson se nuk ka pasur reduktime për mungesë të energjisë elektrike dhe ky është një lajm pozitiv. Por, Raporti përmend shkarazi reduktimet në rastet “kur rrezikohen stabilimentet”. Megjithatë, nuk ka asnjë informatë shtesë se sa ka qenë numri i këtyre reduktimeve, kur kanë ndodhur ato etj, Raporti thekson qartë që: “Bordi i ZRRE **në fund të vitit 2018** ka nxjerrë vendimin për ndalimin e reduktimeve për mungesë të energjisë, përveç në rastet kur rrezikohen stabilimentet”, dhe në të njëjtën kohë është raportuar për 0 reduktime si pasojë e mungesës së energjisë elektrike. Është kryesore të shihen të dhëna për numrin e reduktimeve ku “rrezikimi i stabilimenteve” ka qenë arsyeja.

## **Përfundime dhe Rekomandime**

Raporti Vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2019 ka karakter përshkrues sa i përket përmbajtjes, kursë pjesa analizuese në këtë raport mungon. Ndonëse ka të dhëna të konsiderueshme, paraqitja e disa prej tyre mungojnë prandaj mbetet e shumë mungesa. Me theks të veçantë mund të përmendim mungesën e analizës së impakteve, shkaqeve, analizën krahasuese dhe vlerësime mbi ndikimet e investimeve, vendimeve, veprimeve dhe mosveprimeve në sistemin energjetik në vend dhe interesin publik.

Komisioni parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike duhet të kërkoj nga ZRRE që para se të miratohet rekomandimi pozitiv i Komisionit për Raportin, ketij raportit duhet ti bashkangjitet një dokument me sqarime për të gjitha pyetjet që aktualisht nuk kanë përgjigje në këtë Raport. Më pastaj, Komisioni të shqyrtoj përgjigjet dhe të votoj për miratimin e raportit të plotësuar.

Raporti duhet të paraqes strukturën organizative të Rregullatorit. Përfshirë këtu detaje në lidhje me mandatin e anëtarëve të Bordit, strukturën gjinore, moshën, përgatitjet profesionale, si dhe të dhëna rreth trajnimeve të mbajtura.

Raporti duhet të plotësohet edhe në pjesën ku përmenden dëmet e shkaktuara nga vonesat në procedura të prokurorit nga ana e Agjencisë Qendrore për Prokurorim. Duhet të sqarohen më gjerësisht se cilat sektore janë më të prekura nga këto pengesa. Duhet të behët listimi i tyre duke paraqitur arsyeshmëritë për secilën pengesë.

Në pjesën ku përshkruhen aktivitetet e ZRRE, duhet të formulohet një pasqyrë e thjeshtësuar rreth legjislacionit të nevojshëm. Poashtu në mënyrë shumë specifike duhet të trajtohet pjesa ku flitet për licencat e përkohshme të lëshuara nga ZRRE, pjesë këto të cilat janë mjaftë të paqarta dhe ligjërisht problematike.

Raporti duhet të japë të dhëna rreth aktiviteteve tjera të shumëta të cilat mungojnë, përfshirë këtu pjesën e projektit “Kosova e Re”, licencimin e gjeneratorëve për vetë-konsum dhe procedurat, statusi i draft dokumenti mbi vendosjen e PSO-së për siguri të furnizimit, raporti i detajuar i monitorimit të ndërmarrjeve të energjisë përfshirë raportit të veçantë për monitorimin e KOSTT dhe KESCO.

Bazuar në këto gjetje, dokumenti nuk jep një pasqyrë të plotë rreth gjendjes në sektorin e energjisë pasi që dështon të u përgjigjet një numri të konsiderueshëm të pyetjeve të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e kësaj fushe. Prandaj, i rekomandojmë Komisionit që të kërkoj një raport shtesë nga ana e ZRRE-së me informatat që mungojnë, para se të procedohet për në seancë.

### **Shtojcë - Pyetjet pa përgjigje në Raportin Vjetor të ZRRE-së për vitin 2019**

- 1. Kur u skadon mandati anëtarëve aktual të Bordit të ZRRE-së?**
- 2. Cila është struktura gjinore, e moshës, përgatitjes profesionale dhe përgatitjes në punë e punonjësve të ZRRE-së?**

#### **Lejet e përkohshme**

- 3. Në bazë të cilit ligj lëshohen këto licenca të përkohëshme?**

4. Çfarë masa ndërmerren në rastet kur këto ndërmarrje nuk e sjellin lejen mjedisore?
5. Çfarë ndodhë me mjediset të cilat tanimë ka ndodhur degradime?

#### E drejta për ndërrim të furnitorit

6. Cilat janë arsyet për të cilat furnitorët nuk po ofrojnë shërbime në treg dhe se çfarë ka bërë Rregullatori gjatë vitit 2019 për të përmbushur të drejtën e konsumatorëve për ndërrim të furnitorit?

#### Aktivitetet e Monitorimit

7. Sa monitorime ka pasur gjatë vitit 2019 dhe për çfarë aktivitete?
8. Cilat janë të gjeturat e Rregullatorit në numra sa i takon këtyre monitorimeve?
9. Përse nuk është shqiptuar asnjë gjobë gjatë vitit 2019? Përse Rregullatori nuk ka shqiptuar asnjë gjobë gjatë monitorimit kurse ka raportuar se 73% të ankesave të konsumatorëve kanë qenë të drejta, pra ZRRE ka gjetur se konsumatorët kanë pasur të drejtë plotësisht.

#### Termocentrali “Kosova e Re”

10. Në raportin e vitit 2018, ZRRE i kishte kushtuar një kaptinë të veçantë termocentralit “Kosova e Re”. Përse në këtë raport nuk përmendet askund dhe a ka pasur ndonjë aktivitet nga ana e ZRRE-së në lidhje me këtë projekt gjatë vitit 2019?
11. Çfarë ka ndodhur me PSO-në për vendosjen e obligimit të shërbimit publik mbi furnizuesit që furnizojnë konsumatorët në Kosovë që të paguajnë një taksë për NKEC e cila ishte vendosur në konsultim publik në vitin 2018? A ka marrë vendim Bordi i ZRRE-së?

#### Reduktimet

12. Cili ka qenë numri i reduktimeve “për shkak të sigurisë së stabilimenteve” dhe si është numri i reduktimeve të kësaj natyre ndër vite?

#### Konsultimi me palët e tjera

13. Në konsultimet publike që ZRRE kryen, a i kthyer përgjigje me shkrim dhe sa % të komenteve të palëve janë marrë parasysh gjatë vitit 2019